



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 374 Prot.

Tiranë, më 06.05.2016

**V E N D I M**

**Nr. 52, datë 06/05/2016**

**“Për përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Komiteti Shtetëror për Kultet”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë “Mbi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me zbatimin e Vendimit nr. 13, datë 10.03.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Komiteti Shtetëror për Kultet”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”,

**Vërej se:**

Në zbatim të Vendimit nr. 5, datë 28.01.2015, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në institucionin, Komiteti Shtetëror për Kultet”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është realizuar mbikëqyrja në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me vendimin Vendimin nr.13, datë 10.03.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Komiteti Shtetëror për Kultet”, të Komisionerit, në të cilin është vendosur:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Komitetit Shtetëror për Kultet, pjesë e këtij vendimi.
2. Me miratimin e strukturës së re të institucionit, të dërgohet një kopje pranë Komisionerit, me qëllim që të mundësohet verifikimi i rekomandimeve të parashikuara në raportin e mbikëqyrjes.

3. Të plotësohet dosja e personelit me dokumentat që vërtetojnë gjendjen gjyqësore dhe gjendjen shëndetësore, sipas rekomandimit në raportin e mbikëqyrjes brenda 15 ditëve nga dalja e vendimit dhe të njoftohet me shkrim Komisioneri për realizimin e detyrës.

Me kalimin e afatit procedural prej 15 ditësh, Komisioneri vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për të verifikuar zbatimin e Vendimit nr. 13, datë 10.03.2015, procedurë e bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit.

Procesi i mbikëqyrjes në vazhdim ka filluar bazuar në Vendimin nr. 45, datë 20.04.2016, të Komisionerit, me ngritjen e grupit të punës, i cili u paraqit në subjektin e mbikëqyrur në datën **21.04.2016** dhe i kërkoi personit përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore, nëpunëses \*\*\*\*\*, dosjet e personelit, si dhe çdo akt tjetër administrativ, të nevojshëm për të verifikuar zbatimin e vendimit.

Në përfundim të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, rezultoi se :

- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 2, të pjesës urdhëruese të Vendimit nr.13, datë 10.03.2015, të Komisionerit, rezultoi se deri më tani nuk është hartuar dhe miratuar një strukturë e re për Komitetin Shtetëror për Kultet nga Kryeministri, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, në përputhje me pikën 3 të Vendimit nr. 459, datë 23.9.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet”, të ndryshuar. Për pasojë, Komiteti Shtetëror për Kultet është në pamundësi objektive për të dërguar pranë Komisionerit një kopje të strukturës së re.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 3, rezultoi se ishte bërë verifikimi i gjendjes gjyqësore dhe shëndetësore dhe ishte plotësuar dosja e personelit me aktet që mungonin (*dëshmi penaliteti dhe raport mjekësor*). Dokumentacioni në fjalë ishte administruar në dosjen përkatëse të personelit.

Sa më sipër, u verifikua reagimi i njësisë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, u mbajt procesverbali i konstatimit dhe përfundimisht, arrij në konkluzionin se Vendimi nr. 13, datë 10.03.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Komiteti Shtetëror për Kultet”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është zbatuar plotësisht nga ana e subjektit, **Komiteti Shtetëror për Kultet**.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **V E N D O S A:**

1. Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Komiteti Shtetëror për Kultet.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit nr.13, datë 10.03.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Komiteti Shtetëror për Kultet”*.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Komiteti Shtetëror për Kultet, Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**